

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj – kryetar i kolegjit dhe Rustem Thaçi e Burim Shala – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses NTSH “NN” me seli në Prizren, të cilën e përfaqëson i autorizuari i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) F.P. nga Prizreni, kundër të paditurit S.V. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av.R.H. nga Prizreni, për shkak të borxhit në emër të qirasë, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.228/07, të datës 06.05.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 27.07.2018, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditëses NTSH “NN” me seli në Prizren, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.228/07, i datës 06.05.2014, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.228/07, të datës 06.05.2014, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses NTSH “NN” me seli në Prizren, me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri S.V. nga Prizreni, pronar i firmës private “NN.2.”, që të bëjë pagimin e borxhit në emër të qirasë në shumë prej 2.805,00 €, për periudhën kohore prej muajit qershor 2005 e deri në fund të vitit 2007, si dhe t’i paguajë shpenzimet e procedurës, si tërësisht e pabazuar. Në pikën II të dispozitivit është detyruar paditësi NTSH “NN” me seli në Prizren, që në emër të shpenzimeve procedurale, t’i paguaj të paditurit S.V. shumën prej 350 €, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta anulojë aktgjykimin e atakuar dhe rastin ta kthej në rigjykim.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditëses, është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 28.03.2007, paditësja NTSH “NN” në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurit S.V. për shkak kompensimit të borxhit në emër të qirasë, vlera e kontestit 2.850,00 €, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndëve ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.228/07, të datës 06.05.2014, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses NTSH “NN”, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk ishte kontestuese fakti se këtu palët ndërgjyqëse kanë lidhur kontratë të qirasë për lokalin afarist me nr.207 të datës 23.02.2004. Gjithashtu ka theksuar se nga provat e administruara nga pala e paditur rezulton se ky i fundit i ka përmbushur të gjitha obligimet financiare ndaj paditësit, më saktësisht i ka paguar të gjitha shumat e qirasë deri në fund të muajit mars 2005, kohë kur i padituri e ka liruar lokalin afarist, ndërsa pala paditëse gjykatës së shkallës së parë nuk i ka ofruar ndonjë provë materiale e cila do të vërtetonte ndonjë kontratë të re në mes tyre. Më tutje theksoi se pala e paditur gjykatës së shkallës së parë i ka dërguar edhe urdhërpagesat me nr. 41, të datës 28.01.2005, nr. 101, të datës 14.03.2005 dhe nr.165, të datës 18.04.2005, të cilat vërtetojnë faktin se i padituri i ka kryer të gjitha obligimet financiare në emër të qirasë edhe për muajin janar, shkurt, mars 2005, edhe pse nuk ka pasur kontratë në formë të shkruar për vazhdimsinë e mbajtjes së lokalit afarist me qira nga ana e të paditurit. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e ka nxjerrë duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 i LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet që i referohen gjendjes faktike pasi që gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit ka administruar provat e paraqitura nga palët ndërgjyqësore me të cilat ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në arsyetim të aktgjyimit. Në arsyetim të aktgjyimit gjykata e shkallës së parë i është përmbajtur dispozitës së nenit 160 paragrafi 4 i LPK-së, në atë mënyrë që ka përshkruar kërkesat e palëve, faktet që kanë parashtruar palët, provat e propozuara dhe të administruara, si dhe mënyrën se si janë vlerësuar provat e administruara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadisë është i drejtë dhe i bazuar, pasi që me dispozitën e nenit 17 të LMD-së, i cili ka qenë në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës për shfrytëzimin e lokalit afarist, përcaktohet se *“pjesëmarrësit e detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*, ndërsa në dispozitën e

nenit 262 të po këtij ligji, është paraparë se “kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”, dhe në bazë të nenit 583 të LMD-së, “Qiramarrësi ka për detyrë ta paguaj qiranë në afatet e caktuara me kontratë ose me ligj...”. Në bazë gjendjes faktike të vërtetuar në procedurën para gjykatës së shkallës së parë, është provuar se i padituri i ka përmbushur të gjitha detyrimet të cilat i ka pasur ndaj paditëses, konform kontratës mbi qiranë nr.207, të datës 23.02.2004.

Andaj nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.2245/14, me datën 27.07.2018**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari**  
**Valon Totaj**